




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Arsim

10. Nr 1136 /24

Vushtrri, më 15.11.2024

Në bazë të nenit 17 pika h dhe nenit 62, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Ligjit nr 03/L-068 për Arsimin në Komuna, Drejtoria Komunale e Arsimit merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndalohet përdorimi i Doracakëve: 'Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues, i Shëndoshë dhe i Sigurt' 1-5, 6-9 dhe 10-12, në të gjitha IEAA të Arsimit Parauniversitar në Komunën e Vushtrrisë.
- II. Obligohen drejtoritë e IEAA-AP në Komunën e Vushtrrisë si dhe mësimdhësit/et e niveleve të lartëcekura të mos përdorin përmbajtjen e as shembujt e shpjeguar në doracakun sipas pikës i të këtij vendimi, gjatë zhvillimit të procesit edukativo- mësimorë.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim


Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, ka përcjellur me shqetësim të madh, dhe ka analizuar në tërësi përmbajtjen e doracakut 'Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues, i Shëndoshë dhe i Sigurt', andaj duke konsideruar se kjo përmbajtje është e dëmshme dhe abuzuese me fëmijët besojmë fuqishëm se ky vendim për mos aplikimin e doracakëve është në interesin e nxënësve dhe prindërve të komunës tonë.

Përmbajtja e këtyre materialeve në kontekst të edukimit seksual, është në kundërshtim të plotë edhe me normat shoqërore të vendit tonë si dhe një mënyrë degraduese e keqedukimit të fëmijëve tanë.

DKA, asesi nuk mbështetë doracakë dhe materiale të tilla me përmbajtje denigruese, përdorimi i të cilave ndikon negativisht në zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve.

Bazuar në të lartëcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.




Alban Tahiraj
Drejtör i DKA-së